KFOS
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Fondation for Open Society

AKTIV

kim

OJQ AKTIV

Raporti për rezultatet e hulumtimit

Analiza e trendit 2019.

Qëndrimet e komunitetit serb në Kosovë

Mitrovica e Veriut

Porositësit e hulumtimit

OJQ AKTIV, Radio Kim

Autorët e hulumtimit

Miodrag Marinkoviq

Millosh Timotijeviq

Senka Kostiq

Donatori

Ky hulumtim është realizuar në kuadër të projektit *Analiza e trendit – hulumtimi i opinionit publik të komuniteti serb në Kosovë* i cili zbatohet nga OJQ AKTIV dhe Radio Kim me mbështetjen financiare të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).

Për botuesin

OJQ AKTIV

Adresa: Mbreti Pjetër I, nr. 183a, Mitrovica e Veriut

E-mail: office@ngoaktiv.org

Ueb faqja: www.ngoaktiv.org

Mitrovica e Veriut

Nëntor 2019

PËRMBAJTJA

FJALË HYRËSE 4

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT 6

REZULTATET KRYESORE TË HULUMTIMIT: 7

PËRSHKRIMI I MOSTRËS: 10

REZULTATET E HULUMTIMIT: 12

QËNDRIMET E PËRGJITHSHME 12

BESIMI TE VENDIMMARRËSIT 22

BESIMI NË INSTITUCIONE 27

QËNDRIMI NDAJ PJESËMARRJES AKTIVE NË PROCESET POLITIKE NË KOSOVË 32

LIRIA E SHPREHJES DHE QASJA NË INFORMATA 38

SIGURIA E QYTETARËVE 43

TENDENCAT E MIGRIMIT 47

PIKËPAMJET MBI BASHKIMIN EVROPIAN 49

SHQYRTIM I VEÇANTË: QËNDRIMET NË LIDHJE ME IDENË E DEMARKACIONIT 54

DISTANCA ETNIKE 58

FJALË HYRËSE

Dokumenti para jush është një studim i realizuar për të pestin vit me radhë nga OJQ AKTIV me qëllim të identifikimit të qëndrimeve dhe perceptimeve kryesore të komunitetit serb në Kosovë në lidhje me proceset kryesore shoqërore, ekonomike, politike dhe të tjera që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në jetën e tyre. Të dhënat e fituara ofrojnë një pasqyrë mbi efektet që proceset e tilla kanë në komunitetin serb në Kosovë, nevojat dhe prioritetet e tij dhe, si të tilla paraqesin një burim të vlefshëm të informacionit për krijimin e iniciativave dhe strategjive/politikave qytetare në të gjitha nivelet qeverisëse që synojnë plotësimin e nevojave reale të popullsisë. Rezultatet e këtij hulumtimi mund dhe duhet të bëhen pikënisje për përpjekje të tilla, pa marrë parasysh se a janë ato nisma zhvillimore, dialog shoqëror madje dhe zgjidhje politike për disa nga problemet që për një periudhë të gjatë rëndojnë normalizimin e jetës në Kosovë.

Gjetjet më të rëndësishme të këtij hulumtimi, sa herë që janë justifikuar në mënyrë metodologjike, janë paraqitur përmes analizës krahasuese të rezultateve të hulumtimeve të mëparshme. Kjo gjithashtu ka mundësuar një përmbledhje kronologjike të prirjeve të caktuara, d.m.th. qëndrimeve të komunitetit serb (për periudhën nga viti 2015, kur filloi hulumtimi e deri më sot) dhe identifikimi i devijimeve të vlerave dhe/ose devijimeve numerike, e kështu edhe një analize të shkaqeve të tyre duke i krahasuar ato me zhvillimet përkatëse shoqëroro-politike në të njëjtën periudhë. Kështu, për shembull, në këtë hulumtim është vërejtur një pajtueshmëri në rënien e mbështetjes së idesë të krijimit të një Asociacioni të Komunave Serbe me shfaqjen e idesë së demarkacionit territorial.

Hulumtimi me titull *Analiza e trendit* në periudhën nga viti 2015 deri në vitin 2018 ka përfshirë kryesisht komunitetin serb në veri

të Kosovës. Nga ky vit, mostra është zgjeruar dhe përfshinë komunitetin serb në jug të lumit Ibër, duke bërë që qëndrimet e serbëve të Kosovës të jenë më reprezentative. Zgjerimi i mostrës në tërë komunitetin serb është në përputhje me planin strategjik të AKTIV-it për zgjerimin e veprimtarisë së tij edhe në nivel qendror. Megjithatë, arsye kryesore e zgjerimit të hulumtimit është të njohim rëndësinë e momentit shoqëroro-politik në të cilin aktualisht jetojmë. Për momentin, po promovohen ide dhe nisma politike që do të përcaktojnë në masë të madhe fatin dhe të ardhmen e tërë komunitetit serb në Kosovë. Një ide e tillë është "kolosi" aktual politik, ideja e demarkacionit territorial, një ide që ka krijuar një realitet të ri në marrëdhëniet në mes të Serbisë dhe Kosovës, e cila Marrëveshjen e Brukselit vendosi *ad acta* dhe pushtoi hapësirën politike dhe dialogun në të gjithë Ballkanin Perëndimor, Bashkimin Evropian e madje edhe fuqitë e mëdha si SHBA-në dhe Rusinë. Për këtë arsye, hulumtimi i këtij viti përfshiu për herë të parë një seri pyetjesh në lidhje me idenë e demarkacionit territorial, dhe analizat u dhanë nga këndvështrimet krahasuese të të anketuarve që jetojnë në jug dhe atyre që jetojnë në pjesët veriore të Kosovës. Kështu, kemi dashur të shqyrtojmë qëndrimet, qëllimet, shqetësimet dhe prioritetet e tërë komunitetit serb në Kosovë, dhe të ndihmojmë vendimmarrësit të marrin vendime të cilat marrin parasysh interesat dhe qëndrimet e jo vetëm të një pjese, por të gjithë serbëve që jetojnë në Kosovë.

Miodrag Miki Marinkoviq
Drejtor i programit të AKTIV

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Mënyra e hulumtimit: Sondazhi në terren ballë për ballë (F2F)

Anketa: Pyetësori i përbërë nga 40 pyetje

Periudha e hulumtimit: 15 korrik – 5 shtator 2019

Madhësia e mostrës: 540 të anketuar (270 në veri të Kosovës, 270 në mjediset me shumicë serbe në jug të lumit Ibër)

Lloji i mostrës: Mostër e rastësishme e stratifikuar - stratifikimi bazuar në komunën e banimit

Fokus grupet: Mitrovica e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Shtërpcë

Të intervistuarit: Lubomir Stanojkoviq, politikolog

Srgjan Simonoviq, drejtor i OJQ Humani centar Mitrovica

Darko Dimitrijeviq, redaktor i Radio Gorazhdevac

Tatjana Llazareviq, redaktore e portalit KosSev

Nenad Radosavleviq, drejtor RTV Mir

REZULTATET KRYESORE TË HULUMTIMIT:

92%	**të të anketuarve besojnë se zhvillimet e përgjithshme në Kosovë nuk janë në favor dhe nuk janë inkurajuese për komunitetin serb në Kosovë.**
50%	**të të anketuarve konsiderojnë se efektet e proceseve politike aktuale janë rreziku më i madh si për sigurinë e tyre ashtu edhe për sigurinë e familjeve të tyre (trendi i rritjes).**
41,6 %	**të të anketuarve theksojnë se papunësia dhe gjendja e rëndë ekonomike janë problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohen.**
60,2 %	**të të anketuarve thonë se në Kosovë nuk ka asnjë politikan të cilit i besojnë.**
12,6%	**të të anketuarve thonë se nuk posedojnë dokumente të lëshuara nga autoritetet e Kosovës.**

2,82%	**është vlerësimi mesatar (nga pesë pikë) për Qeverinë e Republikës së Serbisë. Për pyetjen e njëjtë - *a jeni të kënaqur me performancën e saj*, Qeveria e Kosovës është vlerësuar me notën 1,98.**
51,2%	**të të anketuarve mendojnë se ideja e formimit të Asociacionit të Komunave Serbe është braktisur.**
46,9%	**të të anketuarve mendojnë së qëndrimet e pavarura dhe mendimi kritik nuk janë të përfaqësuara mjaftueshëm në media në Kosovë.**
75,6%	**të të anketuarve pohojnë së nuk ndjehen të lirë të shprehin qëndrimet e tyre politike.**
55,3%	**të të anketuarve theksuan se nuk e shohin veten në Kosovë në pesë vitet e ardhshme ose do të largohen nëse u jepet mundësia. Më shumë se dy të tretat e tyre kanë të përfunduar studimet universitare.**

73,3 %	**nga numri i përgjithshëm i të anketuarve nuk e përkrahin idenë e demarkacionit të Kosovës, përkatësisht afër 80% të të anketuarve të komunitetit serb në jug të lumit Ibër dhe rreth 66% në veri të Kosovës.**

PËRSHKRIMI I MOSTRËS:

Janë intervistuar gjithsej 540 të anketuar, nga të cilët pak më shumë se gjysma jetojnë në mjediset në jug të lumit Ibër. Qasja metodologjike kishte për qëllim arritjen e përfaqësimit të lartë të rezultateve në nivelin e gjithë komunitetit serb në Kosovë, por edhe përfaqësimin e mostrës sipas karakteristikave themelore demografike (gjinisë, moshës, arsimit, punësimit etj.).
Në vazhdim janë paraqitur të dhënat themelore mbi strukturën e mostrës së përdorur në këtë studim:

1.1. Struktura e mostrës sipas gjinisë



1.2. Struktura e mostrës sipas vendbanimit të të anketuarve

1.3. Struktura e mostrës sipas nivelit të edukimit



1.4. Struktura e mostrës sipas moshës së të anketuarve



1.5. Struktura e mostrës sipas statusit të punësimit të të anketuarve



REZULTATET E HULUMTIMIT:

QËNDRIMET E PËRGJITHSHME

1. Nga shkalla prej 1 deri në 5, ku 1 është ,,shume keq", dhe 5 ,,shumë mirë", vlerësoni:

	Vlerësimi mesatare
Gjendja juaj materiale	2,39
Gjendja ekonomike në Kosovë	1,79
Gjendja politike në Kosovë	1,79
Gjendja e sigurisë në Kosovë	1,89

Pyetja e parë për të anketuarit kishte të bënte me vlerësimin e përgjithshëm të tendencave kryesore shoqërore dhe vlerësimin e gjendjes materiale personale (të ardhurat, pasuria, punësimi etj.). Në tabelë paraqitet gjendja materiale e cila mesatarisht vlerësohet si "e mirë dhe e keqe", por që gjendja politike, ekonomike dhe e sigurisë vlerësohen si të këqija. Këto rezultate janë në përputhje me gjetjet e hulumtimit të vitit 2018.

Mosha e të anketuarve nuk është një burim i dallimeve në perceptimin e gjendjes politike, ekonomike dhe të sigurisë në Kosovë. Për më tepër, me krahasimin e rezultateve sipas vendbanimit, mund të vërehet se gjendja e tyre si "shumë e keqe" dhe "e keqe" vlerësohet nga një përqindje shumë e lartë e të anketuarve që jetojnë në jug të lumit Ibër në krahasim me bashkëvendësit e tyre nga veriu i Kosovës (Tabela 1.1). Ky dallim i konsiderueshëm në perceptim është përfshirë në një sërë pyetjesh të analizës cilësore (fokus grupe, intervista) ku të anketuarit e shpjegojnë këtë disproporcion përmes "trajtimeve preferenciale" të veriut të Kosovës me investime, grante dhe donacione nga ana e të gjithë akterëve përkatës, përfshirë këtu Beogradin, Prishtinën dhe bashkësinë ndërkombëtare.

1.1. Nga shkalla prej 1 deri në 5, ku 1 është ,,shume keq", dhe 5 ,,shumë mirë", vlerësoni:

a) Gjendjen e juaj materiale.



b) Gjendjen politike në Kosovë



Komuniteti serb në Kosovë, pavarësisht se ku jeton, me më pak apo më shumë dallime, i konsideron tendencat politike si të këqija për interesat e veta. Të anketuarit që jetojnë në katër komuna në veri të Kosovës janë disi më pesimist, ku më pak se 2% e tyre vlerësojnë gjendjen e përgjithshme politike si "të mire" ose "të shkëlqyeshme", ndërsa përqindja e të anketuarve në komunat ne jug të lumit Ibër është dukshëm më e lartë (rreth 12%).

c) Gjendja ekonomike në Kosovë



Ngjashëm me tendencat politike, shumica e të anketuarve tendencat kryesore ekonomike në Kosovë i vlerësojnë si shumë të këqija ose të këqija (dallimet në perceptime në mes të të anketuarve nga veriu dhe zonat në jug të Kosovës nuk janë të konsiderueshme).

d) Gjendja e sigurisë në Kosovë



Situata është e ngjashme edhe në kuptim të perceptimit të sigurisë – përqindja më e lartë e të anketuarve e vlerësuan gjendjen e sigurisë në Kosovë si të keqe apo shumë të keqe. Mirëpo, këtu vërehen dallimet e konsiderueshme në mes të të anketuarve nga veriu dhe pjesët e tjera të Kosovës.

Përkatësisht, katër nga pesë banorë (më shumë se 80%) në komuna me shumicë serbe në veri të Kosovës gjendjen e sigurisë e vlerësojnë si "shumë të keqe" ose "të keqe", ndërsa rreth tre nga pesë të anketuar këtë perceptim e kanë banorët në jug të lumit Ibër (pakë më shumë se 60%).

Përgjigjet e mëparshme tregojnë pakënaqësi të dukshme të komunitetit serb në Kosovë mbi tendencat kryesore shoqëroro-politike në vitin e fundit. Më shumë se 90% e të anketuarve këto tendenca i përshkruajnë si negative. Një prirje e tillë ishte vërtetuar në vitin 2017 dhe reflektohet në vëllim të pandryshuar edhe në tri hulumtimet e fundit (Grafiku 2).

2. Shikuar në përgjithësi, a po zhvillohen gjërat në Kosovës në drejtim të duhur?



Pakënaqësia e dukshme e të anketuarve për tendencat mbizotëruese shoqëroro-politike në Kosovë është shndërruar në një pesimizëm që diçka mund të ndryshoj në drejtim pozitiv. Pothuajse, 93% të të anketuarve konsiderojnë që tendencat e

përgjithshme në Kosovë shkojnë në drejtim të gabuar, ndërsa vetëm 8% mendojnë se jeta e tyre do të jetë më e mirë në tre vitet e ardhshme (Grafiku 3). Pesimizmi i tillë është një tendencë e qëndrueshme dhe pak a shumë manifestohet nga viti në vit, ndërsa dallimet në mes të të anketuarve të cilët jetojnë në veri të Kosovës dhe atyre që jetojnë në zonat në jug të lumit Ibër (Grafiku 3.1.) pothuajse fare nuk ekzistojnë.

3. Sipas mendimit tuaj, jeta për serbët në Kosovë për tre vjet do të jetë:



3.1 Sipas mendimit tuaj, jeta për serbët në Kosovë për tre vjet do të jetë:



4. Sipas mendimit tuaj, cili është problemi më i madh në Kosovë?



Përqindja më e madhe e të anketuarve bindshëm konsiderojnë se problemi më i madh në Kosovë është papunësia (41.6%), ku përqindjet pothuajse janë dyfishuar krahasuar me vitin 2018 (kur ishte 22%), dhe gjendja politike (17.6%). Pas disa viteve të rritjes së vazhdueshme, numri i të anketuarve të cilët si çështje aktuale në Kosovë e shohin korrupsionin dhe krimin ka rënë dukshëm në krahasim me rezultatet e hulumtimit nga viti 2018 (8% në vitin 2016, 11% në vitin 2017, 20,6% 2018; 8,6% në hulumtimin e vitit 2019). Me këtë analizë krahasuese nuk ishte e mundur të konfirmohet tendenca, pasi që nga ky vit në hulumtim është përfshirë komuniteti serb në tërë Kosovën e jo vetëm në veri, siç ishte rasti deri ne vitin 2018.



5. A i prekin problemet kryesore në Kosovë në mënyrë të barabartë serbët dhe shqiptarët?



Përqindja më e madhe e të anketuarve si në vitin e kaluar ashtu edhe këtë vit, konsiderojnë se problemet tek serbet dhe shqiptarët janë të njëjta, por që ndikimi i tyre në komunitetin serb është më i dëmshëm. Kjo sasi e caktuar e empatisë dhe bashkëndjesisë së ballafaqimit me problemet kryesore të njerëzve të zakonshëm, pavarësisht nga përkatësia etnike, nuk është bazuar në kontakte të shpeshta dhe në rritje të vazhdueshme të mirëkuptimit të ndërsjellët. Në grafikun 6 të mostrës së përgjithshme shihet se vetëm ¼ e të anketuarve shpesh shkojnë në zonat ku jetojnë shumica e shqiptarëve të Kosovës. Kur përgjigjet e të anketuarve në veri të Kosovës krahasohen me rezultatet e vitit 2018 (tabela në vijim) vërehet një rënie e dukshme e përqindjes së atyre që kanë ndërveprim të shpeshtë me shqiptarët e Kosovës (një ulje prej rreth 10%). Në pjesën cilësore të këtij hulumtimi (fokus grupet dhe intervistat), kjo rënie i atribuohet përkeqësimit të tendencave politike (p.sh, taksa) të përcjell nga retorika publike "më agresive".

6. Sa shpesh shkoni në zonat ku shqiptarët janë shumicë?



6.1. Sa shpesh shkoni në zonat ku shqiptarët janë shumicë? - krahasimi



7. Eksperienca e juaj nga kontakte personale me shqiptarët kryesisht është:





Në mostrën e të anketuarve që kanë kontakte me komunitetin shqiptar kemi shqyrtuar perceptimin e kontakteve të tilla. Vetëm rreth 17% të të anketuarve i perceptojnë përvojat e tilla si negative. Nga ana tjetër, përqindja e të anketuarve që kanë përvojë pozitive nga kontaktet personale me shqiptarët (19,3%) është pak më e ulët se në vitin 2018 (23,1%), ndërsa është më lartë në krahasim me vitin 2016 (14,9%) dhe 2017 (15,6%). Ky korrelacion vlen vetëm për mostrën e të anketuarve nga veriu i Kosovës sepse në vitet e mëparshme banorët serb në mjediset në jug të lumit Ibër nuk u përshinë në hulumtim.

8. A ka ndryshuar gjendja ekonomike në Kosovë gjatë vitit të kaluar?



Këtë vit, më shumë se 50% të të anketuarve treguan se në Kosovë asgjë nuk ka ndryshuar në krahasim me vitin e kaluar, që është pothuajse identike me rezultatin e hulumtimit të vitit 2018. Nga ana tjetër, këtë vit është një përqindje pak më e ulët e të anketuarve që mendojnë se gjërat janë përmirësuar (6.7%) në krahasim me vitin e kaluar kur ky rezultat ishte 8%.

BESIMI TE VENDIMMARRËSIT

9. Sa shpesh ndiqni zhvillimet politike?



Një përqindje pak më e vogël e të anketuarve (35,3%) deklaruan se po i përcjellin zhvillimet politike, ndryshe nga viti i kaluar kur kjo përqindje ishte 41,7%. Kjo rënie e vogël e interesit të qytetarëve për ngjarje politike që janë të rëndësishme për jetën e tyre të përditshme është e ndërlidhur me vlerësimin e përgjithshëm (në pjesën e parë të këtij hulumtimi) që tendencat kryesore politike në vitin e fundit kanë marrë kahje negative. Si një manifestim i dukshëm i një pesimizmi të tillë, pra perceptimeve negative, gjithashtu është theksuar mungesa e besimit tek liderët në Kosovë (grafiku 10).



10. A ka politikanë në Kosovë në të cilët keni besim?

Gati dy të tretat e të anketuarve (më saktësisht pak më shume se 60%) thekson që asnjë politikan në Kosovë nuk e meriton besimin e tyre. Nga ana tjetër, vetëm 21.6% e të anketuarve kanë një besim të caktuar në politikanët serb të Kosovës, që është në përputhje me gjetjet e vitit të kaluar (11,9%), mirëpo më pak se në vitin 2016 kur kjo përqindje ishte 19% dhe 23% në vitin 2017. Mund të vihet në përfundim se besimi i qytetarëve të komunitetit serb tek liderët politik në Kosovë është vazhdimisht i ulët.

	Frekuenca e të anketuarve në mostër sipas kategorisë së moshave	Vlerësimi mesatar sipas frekuencës së kategorive
18-29	172	6,39%
30-45	195	14,87%
46-65	133	16,54%
66 e më shumë	40	15%

Kur këto rezultate analizohen sipas moshës së të anketuarve, konstatohet se mosbesimi në liderët politik është më i ulët tek të rinjtë (nga 18 deri në 29 vjeç), ndërsa këto përqindje rriten me ngritjen e moshës së të anketuarve.

Ngjashëm me këto rezultate, kur u pyetën për të identifikuar njërin nga politikanët në të cilin kanë besim, 88,7% e të anketuarve nuk kanë cekur asnjë politikan serb të cilit i besojnë, dhe 99,2% nuk kanë përgjigje në pyetjen "cilit politikan shqiptarë më së shumti i besoni". Mosbesimi i deklaruar është një tendencë e qëndrueshme që nga viti 2016, gjë që tregon se një krizë e tillë e besimit ka bazën në perceptimin e vazhdueshëm të banorëve që liderët e tyre politik nuk i marrin

parasysh mjaftueshëm interesat e vërteta të komunitetit serb në Kosovë. Ky përfundim vjen nga Tatjana Llazareviq, redaktore e portalit KosSev, sipas të cilës "*politikanët nuk përfaqësojnë interesat e qytetarëve madje as përqindjen më të vogël të nevojave të tyre*"[1]. Sipas drejtorit të RTV "Mir" nga Leposaviqi, Nenad Radosavleviq, "*politika është bërë mjet për të u pasuruar për të cilin nuk nevojitet as dituria e as profesioni, por vetëm përkatësia politike në kreun e qeverisë*"[2]. Parimi i tillë i angazhimit politik, sipas Radosavleviqit, sjell deri tek ajo që "*politika kuptohet si biznes personal",* që është edhe arsyeja themelore e mosbesimit të madh ndaj politikanëve të komunitetit serb në Kosovë. Me këtë mendim pajtohet edhe Srgjan Simoniviq, drejtor i OJQ Humani centar Mitrovica, i cili thotë se politikanët "*në vend që të promovojnë vlerat njerëzore, provojnë nepotizmin (i cili me këtë gjeneratë të politikanëve ka arritur kulmin) dhe korrupsionin i cili është prezent në të gjitha poret e shoqërisë*"[3].

Mirëpo, rezultatet e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të përfunduara kohëve të fundit në Kosovë japin një pamje krejtësisht të kundërt, sepse sipas rezultateve preliminare në dispozicion në kohën e publikimit të këtij raporti, rreth 98% e votuesve të komunitetit serb i besuan Listës serbe (Srpska lista). Antinomia e vërejtur iu prezantua pjesëmarrësve të fokus grupeve, të cilët e shpjeguan atë si mbështetje e hapur të Beogradit për iniciativën politike në fjalë, duke implikuar që votuesit bazojnë zgjedhjen e tyre në vazhdimësinë e përkrahjes së Qeverisë së Beogradit, megjithëse domosdoshmërish nuk i besojnë eksponentëve të saj në Kosovë.

[1] Intervista me Tatjana Llazareviq, 20.9.2019.

[2] Intervista me Nenad Radosavleviq, 26.9.2019.

[3] Intervista me Srgjan Simonoviq, 17.9.2019.

Politikanët serbë	%	**Politikanët shqiptarë**	%
Ivan Todosijeviq	0,2	Gonxhe Çaushi	0,2
Goran Rakiq	2,4	Hashim Thaqi	0,2
Rada Trajkoviq	0,2	Veton Suroi	0,2
Igor Simiq	0,6	Ramush Haradinaj	0,2
Adrijana Hoxhiq	0,2		
Dallibor Jevtiq	1,3		
Nenad Rikalo	0,2		
Sllavko Simiq	0,2		
Zoran Todiq	0,6		
Bratisllav Nikoliq	3,5		
Srgjan Popoviq	0,9		
Bojan Stojanoviq	0,2		
Nenad Radosavleviq	0,2		
Sllobodan Petroviq	0,2		
Marko Gjuriq	0,4		
Nuk i besoj asnjë politikani	88,7	Nuk i besoj asnjë politikani	99,2%

11. **Serbët nga Kosova në politikën e jashtme dhe lobim kryesisht duhet të mbështeten në:**

Përqindja e mostrës	2016.	2017.	2018.	2019.
BE-në	17,3%	5,3%	13,1%	8,3%
Rusinë	75,5%	64%	51,2%	45,2%
SHBA-në	2,8%	4,1%	2%	5,6%
Nuk ka përgjigje	4,4%	26,5%	33,7%	37,6%

Pasi që çështja e statusit të Kosovës në nivelin ndërkombëtar ka ndikuar rrjedhimisht në stabilitetin rajonal, por edhe në kompleksitetin e marrëdhënieve etnike brenda vetë Kosovës

dhe problemet e ndërkombëtarizuara, ky studim vit pas viti monitoron perceptimet e komunitetit serb në Kosovë mbi atë se në cilat adresa diplomatike ndërkombëtare mund të presin përfaqësimin më të fortë të interesave të tyre. Për shumë vite, pa marrë parasysh tendencën e vazhdueshme në rënie, serbët e Kosovës aleatin më të madh e shohin Moskën, më saktësisht, mbështetjen që Federata Ruse i jep Serbisë në lidhje me Kosovën në institucionet ndërkombëtare. Në këtë rol në një masë shumë më të vogël, të anketuarit i shohin Shtetet e Bashkuara të Amerikës (pak më shumë se 5%) dhe Bashkimin Evropian (rreth 8%).

Mirëpo, këtë vit, për herë të parë, përqindja e të anketuarve që e shohin Rusinë si aleatin e tyre më të madh në skenën ndërkombëtare ka rënë nën 50%. Tatjana Llazareviq, redaktore e KosSev, e sheh këtë si një kombinim të disa faktorëve, siç janë: a) *politika e vërtetë ruse praktikisht është e padukshme në komunitetin serb në Kosovë, përfshirë zyrën ruse në Prishtinë, dhe b) komuniteti i dobësuar serb është në apati dhe pesimizëm të thellë, dhe qytetarët janë të vetëdijshëm se praktikisht janë "lënë vetëm"*[4].

[4] Intervista me Tatjana Llazareviq, 20.9.2019.

BESIMI NË INSTITUCIONE

12. A posedoni dokumente personale të lëshuara nga institucionet e Kosovës?



Pyetja në lidhje me posedimin e dokumenteve personale të identifikimit të lëshuara nga autoritetet e Kosovës lidhet drejtpërdrejt me procesin e integrimit të serbëve në Kosovë. Për shumë vite, posedimi i këtyre dokumenteve u konsiderua një akt i "tradhtisë" së interesave të Republikës së Serbisë, dhe rezistenca ndaj këtij procesi, veçanërisht në veri të Kosovës, është bërë kurs politik mbizotërues. Sidoqoftë, që nga fillimi i bisedimeve të Brukselit (2013), stigmatizimi i këtij akti gradualisht ka filluar të dobësohet, dhe numri i qytetarëve me qëllim të ushtrimit të të drejtave të caktuara të tyre që vendosin të marrin dokumentet e personale të identifikimit të Kosovës është në rritje të vazhdueshme. Kështu, afro 60% në vitin 2017, d.m.th. pak më shumë se 70% në vitin 2018 dhe këtë vit numri i të anketuarve që posedojnë dokumentet e lëshuara nga ana e autoriteteve kosovare është rritur gati në 90% (në saktësisht 87,2%). Edhe pse metodologjikisht kontradiktore (për shkak të shtrirjes së mostrës në tërë komunitetin serb në Kosovë, jo vetëm në veri), kjo prirje është domethënëse sepse tregon "depolitizimin" e këtij akti dhe sjelljen e tij në një "gjest praktik" të domosdoshëm për ushtrimin e të drejtave civile në Kosovë. Thjeshtimet e mëtutjeshme ligjore të këtij procesi (siç kishte paralajmëruar AKTIV-i në një propozim të politikave praktike me

titull "Qasja në dokumente në Kosovë: Një pengesë kryesore për integrimin e komuniteteve jo-shumicë"[5]) do t'i rrisë edhe më tej këto përqindje dhe do t'i lejojë të gjithë qytetarët e kombësisë serbe të gëzojnë të drejtat e garantuara me ligj pa pengesa.

13. A keni përdorur shërbimet e institucioneve të Kosovës?



Posedimi i dokumenteve të lëshuara nga ana e autoriteteve kosovare implikon edhe përmbushjen e kushtit themelorë për realizimin e të drejtave të ndryshme, siç është bashkëveprimi më i shpeshtë me institucionet e krijuara në kuadër të kornizës kushtetuese-ligjore të Kosovës.

Rrjedhimisht, ky parametër gjithashtu ka një pirje të qëndrueshme të ngritjes, kështu që këtë vit 70.5% e të anketuarve deklaruan se kanë përdorur shërbimet e institucioneve të Kosovës, dhe nga kjo rrjedh përqindja më e lartë e atyre që kishin përvojë pozitive, që është pjesërisht në përputhje me rezultatet e hulumtimit të vitit 2018 (nga gjithsej 67% të atyre që theksuar se ishin duke përdorur shërbimet e institucioneve të Kosovës, 44% ishin të kënaqur me shërbimin e ofruar).

[5] http://ngoaktiv.org/uploads/files/Pristup_li%C4%8Dnim_i_putnim_dokumentima%20(1).pdf

	Frekuenca e të anketuarve në mostër sipas kategorisë së moshave	% e atyre që përdorin shërbimet	% e atyre që janë të kënaqur me shërbimin
18-29	172	61%	31,98%
30-45	195	74,36%	47,70%
46-65	133	71,43%	45,86%
66 e më shumë	40	90%	47,5%

Ashtu si rezultatet e vitit 2018, edhe këtë vit, përqindja më e madhe e atyre që përdorin shërbimet e institucioneve të Kosovës është tek të anketuarit më të vjetër, ndërsa një përqindje më e vogël është vërejtur tek të anketuarit e moshës 18 deri në 29 vjeç. Ndërveprimet e rritura me institucionet e Kosovës gjithashtu lejojnë një vlerësim më të besueshëm të tyre, si dhe punën e instancave të tjera të qeverisë ose organizatave që luajnë një rol në zhvillimet në Kosovë (Tabela 14).

Vlerësimi i përgjithshëm është se besimi dhe kënaqësia e qytetarëve për punën e institucioneve është në rënie. Ngjashëm me hulumtimet e kaluara, të anketuarit nga komuniteti serb në Kosovë kanë besimin më të lartë në punën e Qeverisë së Serbisë, dhe më së paku në misionin e EULEX-it dhe Qeverisë së Kosovës. Besimi i qytetarëve për punën dhe angazhimin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë është gjithashtu në një nivel të ulët të qëndrueshëm.

14. **Në një shkallë prej 1 deri në 5, vlerësoni sa jeni të kënaqur me punën/ performancën e institucioneve të mëposhtme:**

	Mesatarja			
	2016	**2017**	**2018**	**2019**
Qeveria e Serbisë	3	2,6	2,9	2,82
Zyra për Kosovë e Metohi	2,8	2,5	2,9	2,51
Katër komuna të sapoformuara të Kosovës në Veri	2,4	2,4	2,8	2,46
Organet e përkohshme të vetëqeverisjes lokale	2,5	2,5	2,5	2,41
Deputetët serb në Kuvendin e Kosovës	2,1	1,8	2,5	2,29
Ministrat serb në Kuvendin e Kosovës	2	1,8	2,4	2,25
UNMIK	2,2	2,2	2,2	2,04
Policia e Kosovës	2,3	2,1	2,1	2,02
KFOR	2,4	2,4	2,3	2,01
Qeveria e Kosovës	1,7	1,6	2,1	1,98
Zyra e BE-së në Kosovë	2	1,9	2,1	1,9
EULEX	1,9	1,7	2,1	1,86

15. **Cili është qëndrimi juaj ndaj Marrëveshjes së Brukselit?**



Në krahasim me rezultatet nga viti 2018, kur 42% të të anketuarve theksuan se nuk e mbështesin Marrëveshjen e Brukselit, këtë vit kjo përqindje ka rënë në 25,2%. Gjithashtu, në krahasim në vitin 2018 (42,2%) këtë vit është përqindja më e lartë e atyre që nuk kanë qëndrim në lidhje me këtë (58,1%). Në pjesën cilësore të hulumtimit, të anketuarit e grupit të fokusit e shpjeguan këtë rënie të konsiderueshme në mbështetje të Marrëveshjes së Brukselit me shfaqjen e idesë së demarkacionit territorial të Kosovës, si një alternative që e bëri të tepërt "procesin e Brukselit". Në njërin nga fokus grupet të komunitetit serb është thënë se: "*Pranimi shumë i lehtë dhe naiv i idesë së demarkacionit të territorit nga ana Bashkimi Evropian, gjithashtu ka nënkuptuar heqjen dorë nga presioni për zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese dhe të arritjes së marrëveshjeve të reja midis Beogradit dhe Prishtinës. Zhdukja e një presioni të tillë u mirëprit nga të dyja qeveritë dhe të dyja plotësisht ndaluan punën për zbatimin e marrëveshjes*". Në bazë të fjalëve të Tatjana Llazareviq "*përkrahja e dobët dhe në rënie në këtë proces ka rrënjët në 'mungesën e theksuar të transparencës', si dhe përshtypjen se procesi i tillë në vitin e fundit është në një "rrugë qorre"*. Ajo më tutje thekson që rënia e përkrahjes është pasojë e praktikës së mos përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes politike dhe gjendjes në të cilën "*proceset politike janë shqyer nga qytetarët, ndërsa qytetarët janë pjesë e atyre proceseve vetëm në atë masë sa është e nevojshme që si "objekte" të plotësojnë procesin i cili dirigjohet në të gjitha anët nga përfaqësuesit qeveritarë me autoritet.*"[6]

[6] Intervista me Tatjana Llazareviq, 20.9.2019.

QËNDRIMI NDAJ PJESËMARRJES AKTIVE NË PROCESET POLITIKE NË KOSOVË

16. Cili është qëndrimi juaj ndaj pjesëmarrjes së serbëve në institucionet e Kosovës?



Ngjashëm me trendin e rritjes së numrit të të anketuarve që posedojnë dokumente personale të identifikimit të lëshuara nga autoritetet e Kosovës, numri i të anketuarve që mbështesin pjesëmarrjen e serbëve në punën e institucioneve të Kosovës po rritet. Në të njëjtin hulumtim nga viti 2018, çdo i katërti i anketuar (ose 24,8%) deklaroi se e mbështetë veprimtarinë institucionale të përfaqësuesve të komunitetit serb në Kosovë, ndërsa këtë vit, një nga tre të anketuar (32%) shprehu këtë mendim. Për rrjedhojë, numri i të anketuarve që shprehen qëndrim negativ për këtë çështje është në një rënie të konsiderueshme, nga 35% në 2018 në 21,7% këtë vit. Është interesante të krahasohet kjo pirje me rezultate të ulëta në pyetjet e besimit dhe kënaqësisë me punën e përfaqësuesve serbë në institucionet e Kosovës. Rritja e mosbesimit dhe pakënaqësisë ndaj performancës së përfaqësuesve të tyre nuk ndikon në qëndrimin e komunitetit serb në lidhje me pjesëmarrjen apo jo, sepse, siç kemi thënë tashmë, numri i serbëve që mbështesin pjesëmarrjen është në rritje të vazhdueshme. Kjo më shumë nënkupton që shkaku i pakënaqësisë qëndron në vendimet e personelit të subjekteve

politike se sa te pengesat institucionale ose legjislative për pjesëmarrjen në pushtet për arritjen e rezultateve që do të perceptohen si një sukses nga komuniteti serb në Kosovë.

Në mbështetje të zgjedhjes në rritje për veprim institucional në mes të komunitetit serb në Kosovë janë rezultatet e paraqitura në Grafikun 17 dhe pyetjet në lidhje me qëndrimet e pjesëmarrjes në procesin zgjedhor brenda kornizës kushtetuese dhe ligjore të Kosovës. Numri i të anketuarve të cilët shprehin qartë vendosmërinë që të marrin pjesë në procesin zgjedhor është në rritje, gati gjysma e tyre pohon që me siguri ose me gjasë të do dalë në zgjedhjet e ardhshme, derisa numri i atyre që shprehimisht refuzojnë të marrin pjesë është në rënie të dukshme (nga 28,6% në vitin 2018. në 16,7% në vitin 2019). Është e rëndësishme të theksohet se në kohën kur është realizuar anketa e këtij hulumtimi, kishte indikacione për zgjedhje të parakohshme parlamentare në Kosovë, por të cilat zgjedhje nuk u shpallën zyrtarisht. Të dhënat për gatishmërinë e daljes në zgjedhje u analizuan në korrelacion me moshën e të anketuarve (tabela më poshtë), ku është konstatuar se përqindja e atyre që janë përgjigjur se me siguri do të dalin në zgjedhje është më e lartë tek të anketuarit e moshës mbi 66 vjeç (45%), dhe më e ulëta për grup mosha nga 18 deri 29 vjeç (18,6%). Rezultatet janë të ngjashme me përqindjet nga hulumtimet e mëparshme dhe janë në korrelacion me konkluzionet e përgjithshme të këtij dhe hulumtimeve tjera të AKTIV-it që tregojnë disfatë dhe pakënaqësi tek të rinjtë e komunitet serb në Kosovë.

16.1. A do të dilni në zgjedhjet e ardhshme të Kosovës kur ato të mbahen?



	Sigurisht që do të votoj
	2019
18-29	18,60%
30-45	36,41%
46-65	31,58%
66 e më shumë	45%

16.2. A do të dilni në zgjedhjet e ardhshme të Kosovës kur ato të mbahen?



Pasi që nga ky vit hulumtimi "Analiza e trendit" përfshinë të anketuarit e komunitetit serb edhe në jug të lumit Ibër, u mundësua analiza e gatishmërisë për të marrë pjesë në procesin zgjedhor nga perspektiva e vendbanimit të të anketuarve. Në këtë mënyrë, hulumtimi ka treguar që të anketuarit të cilit jetojnë në komunat në veri të Kosovës (Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut) në një përqindje dukshëm më të vogël tregojnë gatishmërinë e qartë për të mos dalë në zgjedhje (18,1%) në krahasim me bashkëvendësit në komunat e tjera anembanë Kosovës (42,4%). Rezultatet e pjesëmarrjes në zgjedhjet e parakohshme të mbajtura në 6 tetor 2019 tregojnë një devijim nga këto përqindje në komunat veriore, ku dalja në zgjedhje ishte dukshëm më e lartë se rezultatet e kësaj analize (sipas të dhënave në ueb faqen e portalit KosSev dalja në zgjedhje në veri ishte si në vijim: Mitrovica e Veriut 42,99%, Leposaviq 46,35%, Zveçan 51,63% dhe Zubin Potok 57,34%)[7]. Pjesëmarrësit e fokus grupeve të organizuara për pjesën cilësore të këtij hulumtimi, dallimin e cekur e interpretuan si praktikë e presioneve të ndryshme ndaj votuesve për të dalë në zgjedhje (votimet kolektive, listat paralele të atyre që kanë dalë në zgjedhje dhe dukuritë e ngjashme) që janë më të pranishme në komunat veriore. Sipas këtyre vlerësimeve, dallimin në përqindje e bëjnë ata votues të cilët në rrethana kur nuk ka presion nuk do të marrin pjesë në zgjedhje, por prapë vendosin të dalin në zgjedhje sepse ballafaqohen me forma të ndryshme të presionit. Dukuritë e tilla u konfirmuan edhe nga mediat të cilat ishin të përfshira në monitorimin e procesit zgjedhor, ku janë cekur parregullsi dhe presione të shumta ndaj qytetarëve.

[7] https://kossev.info/izbori-u-brojkama/, 7.10.2019.

17. Çfarë mendoni, a do të formohet Asociacioni i Komunave të Serbe?



Pyetja në lidhje me formimin e Asociacionit të Komunave Serbe mbijeton në këtë hulumtim për vite me rrallë, megjithëse ideja në fjalë në jetën reale politike humbet vrullin. Arsyeja për këtë është rëndësia e jashtëzakonshme e idesë së formimit të një AKS për serbët në Kosovë. Sipas të dhënave të hulumtimit të këtij viti, pesimizmi në mesin e komunitetit serb në lidhje me formimin e Asociacionit të Komunave Serbe po rritet ndjeshëm. Kështu, këtë vit, më shumë se 50% e të anketuarve besojnë se Asociacioni i Komunave Serbe nuk do të formohet kurrë në krahasim me mesataren prej 30%, siç ishte rasti në vitet e kaluara. Arsyeja e kësaj, sipas gjetjeve të të gjitha fokus grupeve është shfaqja e idesë së demarkacionit territorial. Pasi që kjo ide sipas të gjitha indikacioneve dëmton koherencën e komunave me shumicë serbe që do të duhej të përbënin AKS, vet Asociacioni i Komunave Serbe humbë arsyeshmërinë.

18. Në një shkallë prej 1 deri në 5, ku 1 do të thotë "nuk pajtohem plotësisht" dhe 5 "pajtohem plotësisht", si do të vlerësonit qëndrimet e mëposhtme për Asociacionin e komunave serbe?

	Mesatarja
AKS do të kontribuojë në përmirësimin e pozitës së serbëve në Kosovë	2,72
AKS do të kontribuojë në integrimin e serbëve në sistemin juridik dhe politik të Kosovës	2,61
AKS do të mundësojë zhvillimin ekonomik dhe punësimin	2,62

Të anketuarit, edhe këtë vit si në vitin paraprak, mesatarisht kishin një qëndrim neutral (as pajtohen e as nuk pajtohen) për kontributin e AKS-së në zhvillimin ekonomik, integrimin e serbëve në sistemin juridiko-politik të Kosovës dhe përmirësimin e pozitës së serbëve në Kosovë.

LIRIA E SHPREHJES DHE QASJA NË INFORMAT

19. Mbi çfarë bazash krijoni qëndrimet për politikat dhe ngjarjet politike?



Ngjashëm me rezultatet e viteve paraprake, të anketuarit pretendojnë se ndërtojnë pikëpamjet e tyre politike në mënyrë të pavarur (gati 40%) duke u mbështetur në informacionin qe e marrin përmes mediave. Në krahasim me vitin e kaluar, ekziston rritja e besimit në punën e mediave, qofshin ato media me frekuencë kombëtare (nota mesatare mbi 3) apo media të pavarura në Republikën e Serbisë, pa marrë parasysh a bëhet fjalë për mediat që raportojnë në zonat me komunitet serb në Kosovë (2,86; Tabela 20). Një numër shumë i vogël i të anketuarve shfaq besim në informatat që i marrin nga ana e mediave kosovare, përkatësisht nga mediat në Kosovë që raportojnë në gjuhën shqipe, mirëpo, në pjesën cilësore të analizës, të anketuarit e fokus grupeve janë përgjigjur se nuk kanë besim në mediumet shqiptare, dhe se nuk i përcjellin ngase janë në pyetje qëndrimet "parimore" si dhe perceptimet stereotipike. Pengesën më të madhe për këtë e shohin tek dallimet gjuhësore.

20. Në një shkallë prej 1 deri në 5, ku 1 do të thotë "nuk i besoj aspak" dhe 5 "besoj plotësisht", sa iu besoni:

	Mesatarja
Mediave serbe nga Beogradi me frekuence kombëtare	3,01
Mediave të pavarura nga Beogradi	2,93
Mediave serbe në Kosovë	2,86
Mediave në gjuhën shqipe në Kosovë	1,65



21. A janë të prezantuara mjaftueshëm në media në Kosovë qëndrimet e pavarura dhe të menduarit kritik?



Megjithëse krahasuar me vitet e kaluara deri më tani përqindja më e madhe e të anketuarve besojnë se nuk ka mjaft qëndrime të pavarura në këto media (Grafiku 21), dhe se ka një rritje të dukshme të besimit në punën e mediave në Kosovë, gjegjësisht në pavarësinë e tyre dhe raportimin kritik. Kështu, sipas hulumtimit të këtij viti (Grafiku 21.1), pothuajse 20% e të anketuarve, më pak se në vitin 2018, pohojnë se nuk ka kritika të pavarura në mediat në Kosovë. Më konkretisht, në vitin 2018, 2/3 e anketuar (66.9%) e pohuan këtë, ndërsa këtë vit çdo i dyti i anketuar (46.9%).

21.1. Përqindja e të anketuarve që besojnë se qëndrimet e pavarura dhe mendimi kritik nuk janë mjaftueshëm të përfaqësuara në media në Kosovë, nga viti 2016 e deri më tani.



22. A ndiheni të lirë të shprehni publikisht qëndrimet e juaja politike?



Përveç mungesës së mundësive për të dëgjuar mendime të pavarura dhe kritike në lidhje me zhvillimet kryesore shoqëroro-politike, qytetarët, të anketuarit, në një përqindje të papranueshme të madhe, gjithashtu konsiderojnë se nuk ndjehen të lirë të shprehin pikëpamjet e tyre. Madje tre prej katër të të anketuarve (75,6%) konsiderojnë se liria e tyre e shprehjes është e cenuar dhe se ata nuk ndjehen të lirë të shprehin opinionet e tyre publikisht. Në hulumtimin e vitit të kaluar përqindjet kanë qenë të ngjashme. Një përqindje pak më e vogël e të anketuarve në vitin 2018 ka deklaruar se ndjehen të lirshëm të shprehin pikëpamjet politike, por rritja e vërejtur këtë vit nuk është domethënëse në atë masë sa mund të thuhet se ka pasur një përmirësim të vërtetë. Sipas mendimit të redaktores së KosSev, Tatjana Llazareviq, përqindja e atyre që thanë se ishin të lirë të shprehin pikëpamjet e tyre ishte një surprizë apo edhe "përparim domethënës", sepse, siç thotë ajo, "*për fat të keq, në punën, jetën e përditshme - nuk e shoh këtë*"[8].



Grafiku i mësipërm jep një pamje krahasuese të përqindjeve të të anketuarve që mendojnë se nuk kanë liri të shprehjes në katër hulumtimet vjetore të fundit. Vihet re se përkeqësimi në një masë domethënëse fillon në vitin 2017 dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite. Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit në veri të

[8] Intervista me Tatjana Llazareviq, 20.9.2019.

Kosovës e shpjegojnë këtë kërcim të rëndësishëm me presion në rritje për Prishtinën dhe Beogradin për të arritur një zgjidhje gjithëpërfshirëse, d.m.th. dëshira në rritje e qeverive për të kontrolluar diskursin publik në përgatitjen e publikut për zgjidhje të propozuara në përgjigje të një presioni të tillë. Kjo tendencë, për fat të keq, është plotësisht në kundërshtim me praktikën demokratike të krijimit të dialogut të mirëfilltë, gjithëpërfshirës dhe demokratik me pjesëmarrjen e akterëve të ndryshëm shoqërorë rreth çështjeve të rëndësishme politike, e në këtë rast konkret çështjeve kombëtare. Sipas fjalëve të kryeredaktorit të Radio Gorazhdevac, Darko Dimitrijeviq, një përqindje e lartë e të anketuarve që pretendojnë se nuk janë të lirë të shprehin mendimet e tyre, rrjedh nga shkaku i shtypjes së popullatës për të arritur qëllime të caktuara politike. Më tej Dimitrijeviq thotë se: "*Vrasja e Oliver Ivanoviqit, satanizimi i kundërshtarëve të qeverisë aktuale, shpifjet në mediat e kontrolluara nga Beogradi, presionet ndaj pjesës intelektuale të shoqërisë kanë krijuar një atmosferë frike dhe dhune që mbizotëron në komunitetin serb në Kosovë*".[9].

9 Intervista me Darko Dimitrijeviq, 18.9.2019.

SIGURIA E QYTETARËVE

23. A është rrezikuar siguria juaj ose ajo e familjes tuaj të ngushtë në gjashtë muajt e fundit?



Kur është në pyetje siguria e banorëve, gjendja në krahasim me hulumtimet e mëparshme nuk ka ndryshuar shumë. Në tërë mostrën (veri dhe jug) rreth 20% të të anketuarve janë deklaruar se në gjashtë muajt e fundit ata apo anëtarët e familjeve të tyre ishin në situatë në të cilën siguria e tyre ishte cenuar. Në krahasim me vitet e kaluara (2016 - 13%, 2017 - 14%), kjo paraqet një rritje të vogël, më saktësisht një përkeqësim të lehtë të gjendjes së sigurisë. Në dritën e kësaj (Grafiku 24), pothuajse çdo i treti i anketuar nga mostra e përgjithshme (30%) thekson se gjendja e sigurisë është përkeqësuar në vitin e fundit.

Mirëpo, ajo që është interesante është se një numër dukshëm më i madh i të anketuarve nga veriu ishin në atë situatë, 28,4% krahasuar me 13% në jug (grafiku më poshtë). Edhe pse kjo nënkupton që tensionet etnike nuk janë më shkaku i vetëm i përkeqësimit ndjenjës së sigurisë në komunitetin serb (pasi më të cenuar janë në veriun e Kosovës që është etnikisht më kompakt), kjo në këtë hulumtim nuk mund të argumentohet duke marrë parasysh disa incidente masive të sigurisë në veri të Kosovës në vitin e fundit (arrestime masive dhe incidente në

Zubin Potok, disa situata krize dhe përdorimi i forcave speciale të policisë në Mitrovicë, etj.). Incidentet e tilla, të shkaktuara nga paqëndrueshmëria politike ose motivet që të anketuarit i klasifikojnë si të motivuar politikisht dhe etnikisht (shembull arrestimet për rastin e vrasjes së Oliver Ivanoviq), janë identifikuan si rreziqe kryesore të sigurisë (Grafiku 25) nga 50% e të anketuarve, në krahasim me rreth 30% në vitin 2018 (Grafiku 25.1). Sipas fjalëve të drejtorit të RTV "Mir", Nenad Radosavleviq "të gjitha partitë politike në Kosovë tentojnë të arrijnë popullaritetin si strategji për të fituar mbizotërimin politik dhe nën *maskën e patriotizmit dhe të interesit kuazi kombëtarë, përdorin retorikën inflamatore, pas të cilës nuk është e vështirë të arrihet deri në një situatë me incidente*".[10].

23.1. A është rrezikuar siguria juaj ose ajo e familjes tuaj të ngushtë në gjashtë muajt e fundit? - krahasimi



[10] Intervista me Nenad Radosavleviq, 26.9.2019.

24. A ka ndryshuar gjendja e sigurisë në Kosovë në vitin e fundit?



25. Sipas mendimit tuaj, cilat janë rreziqet më të mëdha të sigurisë në mjedisin tuaj?



25.1. Përqindja e të anketuarve në mostër që konsiderojnë se rreziku më i madh i sigurisë në mjedisin e tyre është "paqëndrueshmëria politike" nga viti 2016 e deri më sot.



25.2. Sipas mendimit tuaj, cilat janë rreziqet më të mëdha të sigurisë në mjedisin tuaj?



Përveç paqëndrueshmërisë politike, të anketuarit në një përqindje domethënëse identifikuan si rreziqe të sigurisë personale të tyre edhe incidentet ndëretnike (pak më pak se 20%) ose veprimtaritë kriminale në komunitet (29%). Këto rezultate janë në përputhje me vitin e kaluar. Analiza e mostrës sipas vendbanimit tregon se nuk ka ndonjë ndryshim të madh midis të anketuarve që jetojnë në veri dhe atyre që jetojnë në jug të lumit Ibër në atë që ata e shohin si një rrezik të madh për sigurinë e tyre. Disproporcioni i vetëm ekziston në përqindjen e atyre që e njohën krimin e organizuar (brenda komunitetit serb) si një kërcënim të madh të sigurisë. Në komunat veriore me shumicë serbe, një e treta e të anketuarve (33,6%) dhanë një përgjigje të tillë, dhe në komunat në jug të lumit Ibër kjo përqindje ishte pak më e ulët (25%).

TENDENCAT E MIGRIMIT

26. A e shihni veten në Kosovë në pesë vitet e ardhshme?



A e shihni veten në Kosovë në pesë vitet e ardhshme ?				
		Po	Jo	Do të largohem nëse më ofrohet mundësia
Edukimi	Fillor	73%	19,23%	7,69%
	I mesëm	45,42%	25,35%	29,23%
	I lartë	47,2%	28,8%	24%
	Fakulteti	32,69%	42,31%	25%

Të dhënat nga pjesa paraprake e këtij hulumtimi tregojnë se anëtarët e komunitetit serb në Kosovë janë në një masë të madhe të pakënaqur me kushtet e jetesës, sigurinë e tyre dhe të familjeve të tyre, pronës, prosperitetin ekonomik, performancën e liderëve të tyre të zgjedhur në mbrojtjen e interesave të tyre dhe shumë tregues të tjerë të një jete të sigurt dhe të prosperuar. Prandaj, nuk është për t'u habitur e dhëna që një përqindje e madhe e të anketuarve synojnë të largohen nga Kosova në pesë vitet e ardhshme (rreth 29%) ose nëse u ofrohet mundësia do të largohen nga Kosova (rreth 26%).

	Po	Jo	Do të largohem nëse më ofrohet mundësia
18-29	9,83%	11,69%	10,39%
30-45	15,40%	10,76%	9,83%
46-65	14,47%	5,38%	4,82%
66 e më shumë	5,01%	1,30%	1,11%

Ngjashëm si në vitin 2018, ashtu edhe në këtë vit, çdo i dyti banor me studime të përfunduara shpreh qëllimin që në pesë vitet e ardhshme të largohet nga Kosova. Këto të dhëna janë pothuajse alarmante, sepse largimi i të rinjve dhe personave të arsimuar ka pasoja shkatërruese për aftësinë e komunitetit serb që të ndërtojë një jetë të dinjitetshme dhe të frytshme në Kosovë. Për proporcionin e problemit dëshmon Grafiku 27, sipas të cilit 70% e të anketuarve pohojnë se njohin dikë të afërt që në gjashtë muajt e fundit është larguar nga Kosova. Në krahasim me rezultat e hulumtimeve paraprake, vërehet se ekziston një prirje pothuajse agresive në rritje të dëshmimit të migracionit të komuniteti serb në Kosovë.

27. Në gjashtë muajt e fundit a është larguar ndokush nga rrethi juaj i ngushtë nga Kosova?



PIKËPAMJET MBI BASHKIMIN EVROPIAN

28. .Kur dëgjoni "Bashkim Evropian", a ju asocion së pari në diçka pozitive apo negative?



Perceptimi i Bashkimit Evropian si një sistem vlerash, por edhe një "gjenerues" kryesor i ndryshimit shoqëroro-politik, në përputhje me aspiratat e gjithë pranishme të aneksimit në vendet e Ballkanit Perëndimor, është një tregues i rëndësishëm i drejtimit në të cilin po lëviz një shoqëri. Në mesin e komunitetit serb në Kosovë mbizotëron një perceptim negativ i Bashkimit Evropian (41%), dhe ata që e shohin BE në mënyrë pozitive është vetëm pak më shumë se 10%. Ky qëndrim është dukshëm prezent tek personat e moshës nga 18 deri në 29 dhe atyre deri në moshën 45 vjeçare (shih tabelën në vazhdim) që është edhe një rezultat i cili devijon nga tendencat rajonale. Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit këto qëndrime i kanë shpjeguar me mendime mbizotëruese të komuniteti serb në Kosovë që Bashkimi Evropian punon në të mirë të interesave kombëtarë të shqiptarëve, qoftë me avokim aktiv për pavarësinë e Kosovës në nivel ndërkombëtar ose lënies pas dore dhe "miratimit të heshtur", të politikave/praktikave diskriminuese për serbet në Kosovë të cilat zbatohen nga Qeveria e Kosovës apo shoqëria në përgjithësi. Roli i Bashkimit Evropian si ndërmjetës kryesor i bisedimeve midis Beogradit dhe Prishtinës për arritjen e një marrëveshje gjithëpërfshirëse është, sipas pjesëmarrësve të grupeve të fokusit, baza kryesore dhe shkaku më i rëndësishëm i këtij qëndrimi të komunitetit serb në

Kosovë. Për më tepër, pjesëmarrësit e fokus grupeve në numrin mbizotërues identifikojnë procesin e pranimit të Kosovës në BE me procesin e rrumbullakimit të pavarësisë së saj, dhe si rezultat, madje 43% e të anketuarve (Grafiku 29) besojnë se pranimi i Kosovës në BE do të kishte një efekt negativ mbi ta personalisht. Në krahasim me rezultatet e vitit 2018 (2018 - 37%), ekziston një përqindje më e lartë e të anketuarve që besojnë se asgjë nuk do të ndryshojë me pranimin e Kosovës në BE (49,1% këtë vit). Vetëm një numër i vogël i të anketuarve, të pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë, konsideron se pranimi i Kosovës në BE do të ketë ndikim pozitiv e që është gati se i njëjtë në krahasim me vitin e kaluar (2018 – 13,9%; 2019 – 12,8%).

Mosha	Pozitive	Negative	Neutrale
18-29	2,70%	15,18%	13,89%
30-45	5,37%	13,15%	17,59%
46-65	1,67%	10%	12,96%
66 e më shumë	1,11%	3,52%	2,78%



29. Çfarë ndikimi do të kishte anëtarësimi i Kosovës në BE në juve personalisht?



30. Në një shkallë prej 1 deri në 5 ku 1 "plotësisht nuk pajtohem" dhe 5 "plotësisht pajtohem", vlerësoni vërtetësinë e pohimeve të mëposhtme:

	Mesatarja në 2019.
BE investon mjaftueshëm në mjediset me shumicë serbe në Kosovës	1,90
BE luan rol kyç në pajtimin ndëretnik në Kosovë	2,15
BE luan rol kyç në zgjidhjen e problemeve të komunitetit serb në Kosovë	2,26
BE ka humbur rolin e normalizuesit të marrëdhënieve në Kosovë	2,44

Perceptimet e komunitetit serb për Bashkimin Evropian të përshkruara më lart mund të kuptohen më mirë kur analizohen rezultatet/qëndrimet drejtpërdrejtë të lidhura me angazhimin e BE-së në Kosovë. Sipas hulumtimit, pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë besojnë se Bashkimi Evropian nuk po investon sa duhet në mjediset serbe (nota mesatare 1.9). Përcaktuesi "pamjaftueshëm" u elaborua në fokus grupet, të cilat shpjeguan se klasifikimi "mjaftueshëm/pamjaftueshëm"

përdoret për vlerësim subjektiv të dy faktorëve: nevojat e komunitetit serb për investime dhe investime të balancuara në mjediset dhe komunitetet serbe dhe shqiptare në Kosovë. Prandaj, përfundimi mund të formulohet ashtu që komuniteti serb në përgjithësi konsideron që Bashkimi Evropian po investon proporcionalisht më shumë për komunitetin shqiptar në Kosovë. Në mënyrë të ngjashme, të anketuarit besojnë se Bashkimi Evropian nuk luan një rol kyç në procesin e pajtimit në Kosovë (nota 2.1).

Sidoqoftë, përkundër vlerësimit të pafavorshëm të angazhimit të tij për adresimin e problemeve që komuniteti serb i konsideron si prioritete të tij, Bashkimi Evropian ende konsiderohet si një ndërmjetës kryesor në konfliktin në mes të serbëve dhe shqiptarëve, ose më saktë, si bartës i procesit të normalizimit të marrëdhënieve. Vetëm pak më shumë se 20% e të anketuarve (Grafiku 30.1) mendon që BE-ja e ka humbur këtë rol, ndërsa rreth 80% ende e sheh BE-në dhe pret angazhimin e saj në atë cilësi. Në pjesën cilësore të hulumtimit është saktësuar që ky rol i atribuohet Bashkimit Evropian për shkak të procesit të vazhdueshëm të dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Në mënyrë të ngjashme, të anketuarit sqaruan rritjen relative të dyshimit për rolin drejtues të BE-së në procesin e normalizimit të marrëdhënieve, me shfaqjen e propozimeve për demarkacionin, si një ide që shkaktoi një krizë politike e cila bllokoi dialogun për shkak të mungesës së konsensusit në BE (dhe në vetë komunitetin).

30.1. BE ka humbur rolin e normalizuesit të marrëdhënieve në Kosovë



SHQYRTIM I VEÇANTË: QËNDRIMET NË LIDHJE ME IDENË E DEMARKACIONIT

31. A e mbështesni idenë e demarkacionit të Kosovës?

Ideja e demarkacionit territorial të serbëve dhe shqiptarëve, shpesh e quajtur edhe "ndarja" "korrigjimi i kufijve" etj. është një ide kontroverse (në kuptimin që detajet asnjëherë nuk u zbuluan zyrtarisht), e cila me paraqitjen e saj shkaktoi shumë ndarje në komunitetin serb në Kosovë, por edhe në mënyrë të tërthortë përkeqësoi retorikën dhe lëvizjet e autoriteteve në Prishtinë dhe Beograd duke çuar kështu në një krizë politike. Për shkak të rëndësisë së saj, kjo ide u përfshi në hulumtimin e këtij viti, dhe ne u përpoqëm të përcaktonim jo vetëm mbështetjen e saj në komunitetin serb, por edhe pasojat e mundshme të saj.

Gjëja e parë dhe më e theksuar është se komuniteti serb në një shkallë të gjerë nuk e mbështet demarkacionin. Kjo ide (përkundër mungesës së detajeve/informacioneve) u kundërshtua nga rreth 73% e të anketuarve, ndërsa pak nën 27% e mbështesin ose janë të hapur për një propozim të tillë.

31.1. A e mbështesni idenë e demarkacionit të Kosovës – krahasimi



Pavarësisht nga "sekreti" i caktuar i zgjidhjes së propozuar, retorika e paqartë që shoqëron komunikimin rreth kësaj ideje, sipas të anketuarve të grupit të fokusit dhe bashkëbiseduesve përkatës, demarkacioni midis popullsisë serbe perceptohet si një ndarje e Kosovës përgjatë lumit Ibër, ku katër komunat e veriut të Kosovës do t'i bashkohen Republikës së Serbisë. Meqenëse demarkacioni eventual ka efekte krejt të ndryshme në komunitetin në veri dhe për serbët që jetojnë në zonat në jug të Ibrit, kemi analizuar mbështetjen për këtë ide sipas vendbanimit të të anketuarve. Një analizë e tillë prodhoi rezultatet e mëposhtme: 66% e të anketuarve që jetojnë në veri të Kosovës nuk e mbështesin idenë e ndarjes në Kosovë, ndërsa për 33% të tyre është një zgjidhje e pranueshme; Serbët që jetojnë në jug të lumit Ibër në pothuajse 80% të rasteve nuk e mbështesin ndarjen, ndërsa 20% u përgjigjën pozitivisht (Grafiku 31.1).

Ndërsa të dhënat nga zonat në jug të Ibrit nuk janë për t'u habitur, për shkak të pasigurisë që demarkacioni i sjell komunitetit serb në ato pjesë, përqindja e lartë e kundërshtimit ndaj kësaj zgjidhjeje midis banorëve në veri të Kosovës është

befasuese (vetëm një në tre banorë të veriut të Kosovës e mbështesin këtë ide). Sipas drejtorit të RTV "Mir" Nenad Radosavleviq, "*një pjesë e madhe e qytetarëve që e kundërshtojnë idenë e ndarjes konsiderojnë se Kosova është pjesë e Serbisë*", ndërsa një pjesë tjetër konsideron që demarkacioni si parim "*në të ardhmen mund të sjell konflikte të reja*".[11] Mirëpo, sipas redaktores së portalit KosSev, Tatjana Llazareviq, 80% e të anketuarve nga jugu që nuk mbështesin idenë e ndarjes paraqesin një numër befasues: "*Personalisht, kurrë nuk kam takuar ndonjë serb autentik nga jugu i cili do të mbështeste "demarkacionin" ashtu siç e percepton publiku tani falë interpretimeve të politikanëve - domethënë, pjesa veriore mbetet me Serbi, ndërsa zona në jug të Ibrit mbetet me Kosovë. Jam e befasuar me këtë përqindje – 80% nuk jam e sigurt sa është reprezentative.*[12] Befasinë, siç thotë, për përqindjen e lartë e serbëve në jug të lumit Ibër që përkrahin idenë e ndarjes (20% vërejtja e autorit.) e ndanë edhe drejtori ekzekutiv i OJQ Humani centar Mitrovica, Srgjan Simoviq, duke shprehur bindjen "*që bëhet fjale për të punësuarit në administratë shtetërore (serbe)*".[13] Mendim të ngjashëm ka edhe politikologu Lubomir Stanojkoviq: "*Personalisht mendoj që 20% që janë për demarkacionin është përqindje e madhe. Mundohem ta kuptoj si lodhje nga kohëzgjatja e madhe e këtyre bisedimeve dhe se do të pranojnë vetëm që kjo të zgjidhet një herë e përgjithmonë. Gjithashtu, është shumë e panjohur se çfarë nënkupton demarkacioni, kështu që në kushte të tilla përgjigjet e të anketuarve janë mjaft të paqarta dhe të pasakta*".[14]

[11] Intervistë me Nenad Radosavljeviq, 26.9.2019.
[12] Intervistë me Tatjana Llazareviq, 20.9.2019.
[13] Intervistë me Srgjan Simonoviq, 17.9.2019.
[14] Intervistë me Lubomir Stanojkoviq, 15.9.2019.

Sidoqoftë, OJQ AKTIV ka ardhur deri tek gjetjet identike në hulumtimin e dhjetorit 2018 me temë për ndarje [15], që konfirmon besueshmërinë e rezultatit të fituar.

32. Nëse do të vijë deri te demarkacioni, si do të ndikonte kjo në vendimin tuaj për të qëndruar në vendbanimin tuaj?



Në rast se vjen deri te realizimi i idesë së ndarjes, ekziston një pasiguri e madhe në lidhje me pasojat e atij plani për komunitetin serb në Kosovë, i cili interpretohet në një gatishmëri për të lënë Kosovën nëse vjen deri te ndarja, me përgjigje të pothuajse 40% të të anketuarve. Kjo përqindje është pothuajse identike edhe kur mostra ndahet në të anketuarit në veri dhe ata në jug të Kosovës (Grafiku 32.1).

32.1. Si do të ndikonte demarkacioni në vendimin tuaj të qëndroni në Kosovë?



[15] https://civicenergycenter.org/neë/ëp-content/uploads/2019/10/Podela-Kosova-istra%C5%BEivanje.pdf

DISTANCA ETNIKE

33. Matja e distancës etnike – A do ta pranonit që një shqiptar/e...?



Ashtu si në vitin e kaluar, ne i ndamë këta të anketuar në katër grupe: ata që nuk kanë distancë (0 përgjigje negative), ata me një distancë të vogël (1-2 përgjigje negative), një distancë të moderuar (3-5 përgjigje negative) dhe distancë të theksuar (6-7 përgjigje negative). Bazuar në këtë kemi fituar të dhënat si në vijim:

33.1. Matja e distancës etnike



Këto rezultate tregojnë mbijetesën e distancës së theksuar sipas parimit etnik, më saktësisht armiqësi, perceptime negative, paragjykime dhe stereotipe ndaj shqiptarëve. Pothuajse rezultate identike fitohen kur mostra ndahet në të anketuarit nga veriu dhe ato nga zonat e tjera në Kosovë (Grafiku 33.1), me devijimin e vetëm në grupin e të anketuarve pa asnjë distancë. Në zonat jugore të Kosovës, 10% e të anketuarve hyjnë në kategorinë "pa distancë", ndërsa në veri kjo përqindje është në nivelin e gabimit statistikor (1,1%).

33.2. Matja e distancës etnike - krahasimi



34. Vlerësoni marrëdhëniet aktuale ndëretnike në mes të komuniteteve në Kosovë në një shkallë prej 1 deri në 5, ku 1 është "jashtëzakonisht të këqija" dhe 5 është "të shkëlqyeshme":

	Vlerësimi mesatar
Serbët dhe goranët	3,40
Serbët dhe boshnjakët	2,94
Serbët dhe shqiptarët	1,95

Në bazë të vlerave mesatare, konstatohet se serbët i vlerësojnë më së miri marrëdhëniet me goranët dhe më së keqi me shqiptarët.

34.1. Gjendja e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë - krahasim



Përqindja e të anketuarve që marrëdhëniet me shqiptarët i vlerësojnë si të shkëlqyeshme dhe të mira (11,1%) është më e ulët se në vitin 2018 (18%), por është dy herë më e lartë se në 2016 dhe 2017. Përqindja e të anketuarve që i konsiderojnë marrëdhëniet me boshnjakët si të shkëlqyera dhe të mira (31,7%) është më e ulët se në vitin e kaluar (41,4%), ndërsa perceptimi i marrëdhënieve me goranët është relativisht i qëndrueshëm në krahasim me vitin 2018.

Sa shpesh vizitoni mjediset e banuara nga shqiptarët	Distanca etnike e mesme dhe e madhe në 2018.	Distanca etnike e mesme dhe e madhe në 2019.
Asnjëherë	94,4%	92,5%
Shumë rrallë	83,1%	79%
Shpesh	72,7%	63,46%
Shumë shpesh	53,5%	64,44%

	Distanca etnike e mesme dhe e madhe në 2019.
Shkollimi fillor	57,69%
Shkollimi i mesëm	81,05%
I lartë	80%
Fakulteti	71,15%

Në korrelacion me të dhënat për shpeshtësinë e kontakteve me komunitetin shqiptar (Grafiku 6), ka një ulje të distancës në ato kategori që tregojnë se ata kishin kontakte të shpeshta me komunitetin (individët) shqiptarë. Kjo tregon se ndarja e shoqërisë, mungesa e kontakteve të drejtpërdrejta dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në ndarjen e shoqërisë kosovare nga parimet etnike janë shkaku kryesor i distancës së dy komuniteteve etnike më të mëdha në Kosovë (tabela më lart). Gjithashtu, njerëzit me arsim të mesëm dhe arsim të lartë shfaqin distancë më të madhe etnike sesa të anketuarit që kanë kryer shkollën fillore ose fakultetin. Për më tepër, është e pranueshme që të anketuarit të kenë miq shqiptarë por jo marrëdhënie partneriteti ose familjare.

Distanca etnike ka qenë objekt i hulumtimeve të hollësishme të kryera nga OJQ AKTIV në gjysmën e dytë të viti 2018. Më shumë detaje dhe analiza mbi këtë çështje mund të gjenden në anketën mbi "Perceptimet e ndërsjella të serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë"[16].

[16] https://civicenergycenter.org/neë/ëp-content/uploads/2019/10/Me%C4%91usobne-percepcije-Srba-i-Albanaca-na-Kosovu.pdf

Ky hulumtim është realizuar në kuadër të projektit
Analiza e trendit – hulumtimi i opinionit publik të komuniteti serb në Kosovë,
i cili zbatohet nga OJQ AKTIV dhe Radio Kim me mbështetjen
financiare të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).

KFOS
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Fondation for Open Society

AKTIV

kim